



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 3086 Prot.

Pogradec, më 20.07.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj Kryetare,

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:

**PËR NJË RISHPERNDARJE NË VKB NR 128 DT 22.12.2025, " MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E
BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026"**

Me respekt,

KRYETARI


Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____.____.2026

PËR NJË RISHPERNDARJE NË VKB NR 128 DT 22.12.2025

“ MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026”,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikes te Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise se Financave nr. 2, date 14.01.2026 , "Per zbatimin e buxhetit 2026, VKB 128 dt 22.12.2025 “Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026 " Këshilli Bashkiak :

VENDOSI:

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve si më poshtë:

Pakesohet

Enti Qeverisje	Ministria Linjes	Kodi Institucion	Emer Institucionit	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deg.Thesarit	Debiti 2026	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit
136	00	2136001	BASHKIA	01	04520	2310000	1529	9,400,000	1360433	Emertimi i Projektit Ura e Zëmçës Kryqezimi Proptisht, Bishnice

Shtohet

Enti Qeverisje	Ministria Linjes	Kodi Institucion	Emër Institucionit	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deg.Thesarit	Debiti 2026	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit
136	00	2136001	BASHKIA	01	01110	2310000	1529	9,400,000		Rehabilitimi i godines se Ish Gjeologjiise

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, Ndermarrja e Mirembajtjes se Infrastruktures dhe Puneve Publike te Bashkise Pogradec.

3. Ky Vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes.

KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 3076 Prot.

Pogradec, më 20.07.2026

RELACION

Të nderuar!

Ky Projekt Vendimi i dorëzuar pranë Këshillit Bashkiak Pogradec ka të bëjë me rishpërndarjen e fondeve për "Rehabilitimi i godines se Ish Gjeologjise". Fondet do të rishpërndahen si më poshtë:

Pakesohet

Enti Qeverisje	Ministria Linjes	Kodi Institucion	Emër Institucionit	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deg. Thesarit	Debiti 2026	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit
136	00	2136001	BASHKIA	01	04520	2310000	1529	9,000,000	1360433	Ura e Zëmçës Kryqezimi Proptisht, Bishnice

Shtohet

Enti Qeverisje	Ministria Linjes	Kodi Institucion	Emër Institucionit	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deg. Thesarit	Debiti 2026	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit
136	00	2136001	BASHKIA	01	01110	2310000	1529	9,000,000		Rehabilitimi i godines se Ish Gjeologjise

Përsa i përket objektit "Ura e Zemces - Kryqezimi Proptisht - Bishnice", ky objekt është i prokuruar dhe në buxhetin e vitit 2026 është planifikuar për likujdim dhe jo për prokurim. Likujdimi i tij do të kryhet kur të dorëzohen pranë Bashkisë situacionet përkatëse. Për sa kohë që Drejtoria e Financës nuk disponon situacione dhe fatura për likujdim, na lind e drejta që të bëjmë rishpërndarjen e fondit.

"Rehabilitimi i godines se Ish Gjeologjise" është objekt për të cilin Bashkia Pogradec ka disa vite që përpiqet për kompletimin e dosjes për marrjen e pronësisë së saj. Kjo godinë do të ketë impakt të madh në qytetin tonë për shkak se apartamentet e godinës do të përdoren për strehim social.

Prandaj është parë e nevojshme që të bëhet rishpërndarja e fondeve si më lart.


Bashkëngjitur këtij Relacioni është dhe Relacioni tjetër shpjegues me detajet se çfarë do të kryhet konkretisht në godinë.

Ju Faleminderit,

Konceptoi: Irsa Karapança

Miratoi: Alma Kanina

Konfirmoi: Dritan Babasuli



KRYETAR

ILIR XHAKOLLI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

Nr. 3056 prot

Pogradec, më 20.07 2026

RELACION

**“PËR REHABILITIMIN E GODINËS ‘ISH-GJEOLGJIA’, DHE NDARJEN E SAJ NË
APARTAMENTE BANIMI TË CILAT DO TË SHËRBEJNË NË FUNSKION PËR BANESA
SOCIALE, NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC”**

Ky relacion ka për qëllim paraqitjen e propozimit teknik dhe ligjor për miratimin e projektit të rikonstruksionit dhe ndarjes së brendshme të katit të dytë dhe të tretë të godinës trekatëshe “ish-Gjeologjia” (në pronësi të Bashkisë Pogradec me certifikatë të rregullt pronësie), përmirësimin e kushteve të banimit të disa familjeve ekzistuese, riparimin e soletës, si dhe miratimin e strehimit të përkohshëm social për familje të tjera të cilat plotësojnë kushtet ligjore dhe sociale sipas legjislacionit në fuqi.

I. BAZA LIGJORE

Ky propozim mbështetet dhe hartohet në zbatim të legjislacionit në fuqi:

Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” në Republikën e Shqipërisë;

VKM-së Nr.421 dt.10.06.2026 “Për Transferim në Pronësi të Bashkisë Pogradec, ‘Godinën e ish-Gjeologjisë’...”,

Akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 22/2018;

Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (rregullat e ASHK/Hipotekës për proceset e legalizimit);

VKB nr. 104, datë 27.09.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Pogradec”;

VKB nr. 63, datë 29.05.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programet e strehimit social”;

VKB nr. 23, datë 25.02.2026 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qerasë dhe nivelit të qerasë mesatare në tregun e lirë”.

II. GJENDJA EKZISTUESE E GODINËS DHE PROJEKTI I RIKONSTRUKSIONIT

Bashkia Pogradec ka në pronësi godinën 3-katëshe të njohur si “ish-Gjeologjia”, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me Pasuri nr. 9/1+1-4 dhe 9/1+1-5, Zona Kadastrale 8581, me adresë Lagjia nr.2, Pogradec. Kjo godinë aktualisht shërben si banesë sociale ku janë të strehuara disa familje të cilat janë pajisur me dokumentacion të rregullt.

Me qëllim rritjen e efikasitetit të shfrytëzimit të pronës publike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, Bashkia Pogradec, ka parashikuar një ndërhyrje të plotë rehabilituese në këtë objekt që konsiston në:

- 
1. Riparimin e soletës (tarracës): Eliminimi i lagështirës dhe izolimi termik i godinës për të garantuar standardet e banimit.
 2. Riorganizimi dhe rikonstruksioni i godines për 2 kate e cila do të ndahet përmes mureve ndarëse në apartamente të madhësive të ndryshme të përshtatshme për strukturat për familje te cilat jane te pastreha, konkretisht apartamente të tipit 2+1 (për familje me më shumë anëtarë), 1+1 (për familje me 2-3 anëtarë) dhe Garsoniere (për individë të vetmuar ose çifte të moshuarish).
 3. Rritja e kapacitetit strehues: Përmes këtij riorganizimi krijohet mundësia reale për të strehuar edhe familje të tjera që aktualisht gjenden në kushte emergjente të pastrehe.
 4. Të gjitha ndërhyrjet që do të kryhen sipas punimeve, rregullimit e soletës, rikonstruksionit apo dhe ndarjeve në apartamente sipas tipologjisë, do të kryhen sipas preventivit bashkëngjitur nga D.P.K.ZH.T Bashkia Pogradec.

III. PËRFUNDIME DHE PROPOZIM

Ky investim i brendshëm i Bashkisë Pogradec jo vetëm që ruan dhe rehabiliton një aset të rëndësishëm të pronës publike, por zgjidh në mënyrë të qëndrueshme emergjencën e strehimit për familje të komunitetit tonë që ndodhen në kushte ekstreme të mbijetesës dhe pamundësisë ekonomike.

Nisur nga sa më sipër, Sektori i Strehimit pranë Drejtorisë së Emergjencave, Strehimit, Shpronësimeve dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të tokës dhe supervizimit të shërbimeve në bashkëpunim me D.P.K.ZH.T (Urbanistinkën), Dr.Financës dhe Dr.Juridike, i propozon Këshillit Bashkiak:

Miratimin e fondit të rikonstruksionit të plotë të soletës, sistemimit dhe riorganizimit të brendshëm të godinës per strehim social 'ish-Gjeologjia' (Z.K 8581, Pasuri nr. 9/1+1-4 dhe 9/1+1-5) të dy kateve (Bashkëlidhur, preventivi dhe dokumentacioni).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ftojme këshiltarët ta votojnë.

Konceptoi : D.DRAGOJ

Pranoi : E.DULELLARI

Miratoi : N.TORRA

Konfirmoi : P.ZIKO

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ . 2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR REHABILITIMIN E GODINËS ‘ISH-GJEOLOGJIA’, DHE NDARJEN E SAJ NË APARTAMENTE BANIMI TË CILAT DO TË SHËRBEJNË NË FUNKSION PËR BANESA SOCIALE, NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC ”

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Bazuar në Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: “Akti normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 “a”, të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik, ku si objekt është një pasuri konkrete e Bashkisë Pogradec (godina ‘ish-Gjeologjia’ pasuria nr.3/56, zk. 8581). Ky projekt-vendim nuk vendos rregulla të përgjithshme e abstrakte por rregullon një situatë konkrete, jo një kategori të pacaktuar rastesh.

Gjatë zbatimit të tij, ky projekt-vendim kërkon miratimin e një projekti të caktuar rehabilitimi dhe riorganizimi të kësaj godine në apartamente për banesa sociale. Nuk u drejtohet të gjithë qytetarëve apo një kategorie të papërcaktuar, por ka efekt mbi një objekt të caktuar dhe administrimin e tij. Përfituesit konkrete përcaktohen me vendime të Komisionit të Strehimit. Pra është një akt administrativ individual, sipas kuptimit të Kodit të Procedurave Administrative.

Perfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës administrative individuale dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Konceptoi: N. NAUN



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, ADMINISTRIMIT TOKES NJA DHE SHERBIMEVE

Nr. 2761 prot.

Pogradec, më 28.06. 2026

Lënda : Kërkese per fillim procedure prokurimi.

DREJTORISE EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERITORIT

DREJTORISE E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

KETU

Ne zbatim te Vendimit te Keshillit Ministrave dhe të VKM nr. 421, datë 10.06.2026 "Për transferimin ne Pronesi te Bashkise Pogradec te pasurive 9/1+1-4 dhe 9/1+1-4 Zona Kadastrale 8581 me vendndodhje ne Njesine Administrative Pogradec, dhe per nje shtese ne VKM nr 1240 date 10.09.2008 Për miratimin e listës të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkise Pogradec, të qarkut të Korçës" te ndryshuar, ne pronesi te Bashkisë Pogradec kane kaluar pronat e mesiperme, duke qene se gjendja e tyre eshte e amortizuar dhe ne gjendje te keqe, dhe mbasi keto banesa jane destinuar per strehim social, kerkojme fillimin e procedurave te prokurimit qe nga fondet e 4% te strehimit social te paguara nga ndertuesit, te kalojne per rikonstruksionin e dy kateve te kesaj godine.

Bashkangjitur dy preventiva qe ne disponojme per kete godine.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

**DREJTORI
NEXHMI TORRA**



Seriali: B079A027-ECD0-48D7-A29F-1DFCCCCC2FC95

MIRATOHEJ
KRYETARI I BASHKISE
ILIR XHAKOLLI

Data: 22-06-2026

Projektoreshi: Klajdi Ilo
Objekti: Sistemi i terraces rruges Rinia

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMERTIMI I PUNIMEVE.	NJESIA	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1	2.426/14	1. PRISHJE Prishje shtrese h/izolim tarace	m2	20	358.20	7,163.96
2	2.197	2. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE CATITE Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	161	1,587.65	7,163.96
Shuma Analiza		SHUMA 2:			1,587.65	255,611.65
Fondi Rezervë (0.0%)						255,611.65
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (0.0%)						262,775.61
Shuma TVSH (20%)						0.00
Shuma me TVSH						262,775.61
Totali						52,555.12
						315,330.73
						315,330.73

Preventivuesi: Klajdi Ilo

Investitori: Bashkia Pogradec

Seriali: 5C305EBD-CE70-424C-9C20-A8BF2FCC4672

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE

ILIR XHAKOLLI

Projektuesi: Klajdi Ilo
Objekti: REHABILITIMI I GODINES SE ISH GJEEOLOGJISE

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PRISHJE				
1	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m3	11	2,541.22	27,953.42
2	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	118	344.01	40,593.18
		SHUMA 1:				68,546.60
		2. PUNIME SHITRESASH 2				
3	2.281	Heqje pllaka dyshemeje	m2	15.3	368.43	5,636.98
4	2.267b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	m2	199.7	3,218.44	642,722.47
		SHUMA 2:				648,359.45
		3. PUNIME DYER DRITARE				
5	2.388/1	V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	33.72	13,985.76	471,599.83
6	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	3.28	11,427.40	37,481.87
7	2.373/1	F V vetrare d/alumini plastike me dopio xham	m2	7.5	12,592.15	94,441.13
8	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	39.27	11,343.49	445,458.85
		SHUMA 3:				1,048,981.68
		4. PUNIME DHEU				
9	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	46	467.28	21,494.88
		SHUMA 4:				21,494.88
		5. PUNIME MURATURE TULLE				
10	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, L.L.P. M-25	m3	78	15,418.60	1,202,650.80
11	2.86.	Mur me tulla me 6 vrime, t=12cm h~3m, ll perz M 15	m3	10.3	15,742.38	162,146.51
		SHUMA 5:				1,364,797.31
		6. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE				
12	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze	m2	347	3,826.70	1,327,864.90
13	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	72	973.87	70,118.64
14	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	81	1,140.82	92,406.42
		SHUMA 6:				1,490,389.96
		7. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
15	2.310	Suva brenda mur-tulle ~ 4m, me krah, llac perzier M 25	m2	568	1,052.85	598,018.80
16	2.300	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m2	216	1,616.96	349,263.36
17	2.324a	Plintuse pllake grez	ml	399	338.24	134,957.76
18	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	56.1	2,809.09	157,589.95
		SHUMA 7:				1,239,829.87
		8. PUNIME BOJATISJE				
19	2.404	Boje hidroplastike	m2	1871.7	238.38	446,175.15
20	2.405	Pragje dritare me pllake granili te armuar me bojra	m2	8.48	3,213.78	27,252.85
		SHUMA 8:				473,428.70
		9. NENSHITRESA DHE SHITRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE				
21	2.276/a	Shtrese parketi laminat	m2	128	4,876.69	624,216.32
		SHUMA 9:				624,216.32
		10. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE				
22	2.520	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110	ml	15	1,446.26	21,693.90
23	2.516/1	F.V. Tuba e rakorderi PVC	kg	32	713.20	22,822.40
24	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50	copë	5	2,228.45	11,142.25
25	2.491/2a	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t= 2.0 mm, Pn 10	ml	105	210.55	22,107.75
26	2.491/2b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t= 2.0 mm, Pn 10	ml	40	232.70	9,308.00
27	2.479	F.V Saraçineske PPR 1/2"	copë	48	905.62	43,469.76
28	2.495	F.V lavaman porcelani	copë	6	11,139.64	66,837.84
29	2.501	F.V WC allafrenga	copë	6	19,222.42	115,334.52
		SHUMA 10:				312,716.42
		11. INSTALIME PER NDRICIM				
30	2.480/1	F.V tub plastmasi Ø 14-17mm	ml	337	166.58	56,137.46
31	2.481/1	F.V perçelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	674	38.99	26,279.26
32	2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	79	649.85	51,338.15
33	2.486	F.V Portollampa norm 10 A	copë	40	298.44	11,937.60
34	2.487	F.V Kutiderivacioni plastm	copë	89	179.77	15,999.53
35	2.489	F.V Siguresa ~ 25 A	copë	26	465.94	12,114.44
36	2.490	F.V kuader ndricimi	copë	6	2,282.68	13,696.08
37	2.490/c	F.V Kasete plastike KE me 8 modular (vende)	copë	4	1,447.40	5,789.60
38	2.487/a	F.V kuti suport pllaket 2 mod	copë	12	321.83	3,861.96
39	2.537	F.V. Automat termo-elektro magnetik, 4P, 380V, 40A	copë	1	2,322.90	2,322.90
		SHUMA 11:				199,476.98
		Shuma Analiza				7,492,238.17
		Shuma TVSH (20%)				1,498,447.63
		Totali				9,990,685.80

Preventivuesi: Klajdi Ilo

Investitori: Bashkia Pogradec



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT BASHKËPRONËSISË, ADMINISTRIMIT
TOKES NJ.A, TRANSPORTIT DHE SHERBIMEVE.

Nr. 2601 Prot.

Pogradec, më 17.06.2026

Lënda : Kërkesë për regjistrim në bazë të ligjit dhe paisje me kopje kartele dhe harta treguese dhe certifikat pronësie.

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE
POGRADEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, të Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM nr. 421, datë 10.06.2026 "Për transferimin në Pronesi të Bashkisë Pogradec të pasurive 9/1+1-4 dhe 9/1+1-4 Zona Kadastrale 8581 me vendndodhje në Njesinë Administrative Pogradec, dhe për një shtesë në VKM nr 1240 datë 10.09.2008 Për miratimin e listës të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës" të ndryshuar, si dhe aplikimin e në ealbania nr 6748 datë 15.16.2026, për regjistrim dhe paisje me 2 kartela pasurie, dhe 2 harta treguese, si dhe 2 certifikata pronësie.

Kerkojme regjistrimin në bazë të ligjit dhe paisjen me certifikatë pronësie, kopje kartele pasurie dhe harta treguese për pasuritë e mëposhtme:

N r	Prone sia	Zona Kadastrale	Nr Pasurise	Vendodhja	Lloji	Sipërfaq ja në m2	E drejta që kerkohet
1	Shtet	8581	9/1+1-4	Pogradec	Apartament	281	Pronesi
2	Shtet	8581	9/1+1-5	Pogradec	Apartament	281	Pronësi

Bashkangjitur po ju dergojmë VKM nr 421 si dhe planimetritë për këto pasuri, si dhe aplikimet për këto.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj jemi në pritje të dokumentave!

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

(ME URDHER DHE DELEGIM)
SEKRETAR I PERGJITHSHËM
DRITAN BABASULI



Pagesa për shërbimet

Drejtoria
Vendore/Zyra: Z.V.R.P.P. POGRADEC

NIPT: K54104601V

Data e lëshimit të faturës: 15/06/2026

Nr. fature: 6586

Adresa:

Klienti: bashkia pogradec

Nr.i kërkesës për shërbime: 6748 datë: 15/06/2026

ID/NUIS: K44802605R

Pagesat për tatim/taksë kalim të drejtë

Klienti: bashkia pogradec

Nr.i kërkesës për shërbime: 6748 datë: 15/06/2026

ID/NUIS: K44802605R

	Përshkrimi i shërbimit	Kodi i llogaritës ekonomike	Përfutuesi	Bashkia/IBAN	Vlera (lekë)
1	Shërbime (...)	7112300	Z.V.R.P.P. POGRADEC	Credins- AL2621211009000000000772782	1400
2	Gjorbë për vonesë (...)	7115416	Z.V.R.P.P. POGRADEC	Credins- AL2621211009000000000772782	0

	Emërtimi i të ardhurës	Kodi i llogaritës ekonomike	Përfutuesi	Thesar/Banka	Vlera (lekë)
3	Taksa e kalimi të së drejtës së pronësisë 97%	-	-	-	0
4	Taksa kalimi të së drejtës së pronësisë 3%	-	-	-	0

	Emërtimi i të ardhurës	Kodi i llogaritës ekonomike	Përfutuesi	Banka/IBAN	Vlera (lekë)
5	Tatim për kalimin e të drejtës së pronësisë	-	-	-	0

PAGESA PER ASHK	Të ardhura për ASHK (1+2+4)	1400
	Tatim i kalimit të së drejtës së pronësisë (5)	0

PAGESA PËR BASHKINË taksë kalim të drejtë pronësie (3)	0
--	---

PAGESA TOTALE PËR APLIKIMIN (1+2+3+4+5)	1400
---	------

Pagesa duhet të kryhet nga subjekti brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i përcjelljes në mënyrë elektronike nga ASHK.

Pagesa mund të kryhet edhe pranë Postës Shqiptare.

Kjo faturë është miratuar me Urdhërin nr.35, datë 11.11.2009 nga Ministria e Financave.



1.Tarifat e shërbimeve kadastrale janë të miratuara me VKM nr.389, datë 13.05.2020, i ndryshuar.

2.Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë llogaritet në bazë të ligjit nr.9632, datë 30.10.2016 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

3..Tatimi i kalimit të së drejtës së pronësisë llogaritet në bazë të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", Udhëzimit nr.34, datë 29.12.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të pahuajtshme.

KËRKESË PËR SHËRBIME KADASTRALE

ASHK

1. TË DHËNAT E KËRKESËS

Nr. 6748, Datë 15/06/2026, Afati i përfundimit 13 ditë nga e nesërmja e konfirmimit të pagesës

AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS -Drejtoria Vendore/Zyra Z.V.R.P.P. POGRADEC

Aplikimi realizuar nga: ASHK Institucionet

2. TË DHËNAT E SUBJEKTIT ¹

Emër, Atësi, Mbiemër/Emërtimi tregëtar: bashkia pogradec

ID/NUIS: K44802605R

Lloji dhe numri 0 i dokumentit të identifikimit

Tel: +355 682020137

Adresa e subjektit:

2.1. Përfaqësuesi i autorizuar është i njëjtë me aplikantin²

Po ☐ Jo ☒

Emër, Atësi, Mbiemër/Emërtimi tregëtar:

ID/NUIS:

Lloji dhe numri i dokumentit të identifikimit

Tel: -

Adresa e subjektit:

*Numri dhe data e dokumentit të përfaqësimit

3. TË DHËNAT E PASURISË

Nr. rendor	Nr. zonës kadastrale	Nr. pasurisë	Kodi Unik	Bashkia	Adresa
1	8581	9/1+1-4	8581008216	POGRADEC	"INDUSTRIALE"
2	8581	9/1+1-5	8581008215	POGRADEC	"INDUSTRIALE"

4. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Nr. rendor	Lloji i dokumentit	Numri i dokumentit	Data e dokumentit	Numri i fleteve
1	Vendimi i Komsionit te kthimit	0		0
2	Akt administrativ per venie ku	0		0
3	Vendim gjyqesor perfundimtar	0		0
4	Shkrese percjellese nga instit	0		0
5	Dokument identifikimi	0		0
6	Te tjera	0		0
7	Dokument shitesë	0		0

5. SHËRBIMET, TARIFAT DHE AFATET

Nr. rendor	Emërtimi i shërbimit	Kodi i Shërbimit	Njesia/Sasia	Vlera e tarifës	Tarifa Totale	Gjohë për vonesë	Afati/ditë
1	Regjistrimi i kalimit të p	ASHK_R2	2	100	200	0	13
2	Lëshim certifikate pron	ASHK_L1	2	300	600	0	5
3	Lëshim kopje kartelet të	ASHK_I5	2	150	300	0	5
4	Lëshim kopje të fragme	ASHK_I4	2	150	300	0	5
	Totali				1400	0	

1 Subjekt kërkuar i shërbimeve kadastrale sipas ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën", janë pronarët, titullarët e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, personat fizikë ose juridikë, që kanë interes të ligjshëm mbi pasuritë, si dhe noterit në respektim të shkronjës "k", pika 1 të nenit 63 të Ligjit nr.110/2018 "Për Neterinë".

2 Kërkesa për shërbime kadastrale mund të realizohet nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër dhe për llogari të subjektit, në përputhje me nenin 72 të Kodit Civil duke plotësuar të dhënat (numri dhe data) e aktit të përfaqësimit dhe duke ja bashkëlidhur atë kërkesës. Kërkesa për shërbime kadastrale që paraqitet rregullisht, trajtohet në çdo rast jo më vonë se 21 ditë. Afati për dhënien e shërbimeve kadastrale fillon të llogaritet nga dita e nesërme e konfirmimit të pagesës së tarifës së shërbimit. Kur kerkohen disa shërbime që kanë afate të ndryshme, afati për dhënien e shërbimit fillon të llogaritet nga e nesërmya e konfirmimit të pagesës për shërbimin me kohëzgjatje më të madhe.

Nëpërmjet kësaj kërkesë autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale në përmbajtje të saj, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit, në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

ASËTET
H. Tolu
[Signature]

V E N D I M

Nr. 421, datë 10.6.2026

P Ë R

TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEÇ
TË PASURIVE 9/1+1-4 DHE 9/1+1-5, ZONA KADASTRALE 8581,
ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE POGRADEÇ,
DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1240, DATË 10.9.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI
OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË POGRADEÇ, TË QARKUT
TË KORÇËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec të pasurive 9/1+1-4 dhe 9/1+1-5, zona kadastrale 8581, me vendndodhje në njësinë administrative Pogradec, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planimetrive, gjithsej, 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t'u përdorur në fushën e strehimit social.
2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", të ndryshuar.
3. Bashkisë Pogradec i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

Arbiter sot dt 12.06.2026

4. Ngarkohen Bashkia Pogradec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".


KRYEMINISTRI

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ALBANA KOÇIU

A large, stylized handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long vertical stroke at the bottom.

I. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTISIME SHITETEROR
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia Pogradec		Identifikoi: Spartak KUQO Specialist Nexhmi TORRA Drejtor		Supervizori: Paskalino ZIKO Nënkruesor		Aprovoi: Ilir XHAKOLLI - Kruesor				
Fusha e perdorimit te prones: Strehim Social										
A			B							
Nr. Karta Zonakadastrale / Indeks i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones vendosur / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa vendndodhja e Komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m2 ose m	Funksioni per te cilin perdoret pronja	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
1	3581/PG-E-4	9/1-1-4 Apartament	Ndërtese ish Ndërmarrja Gjeologjike	Lagja nr 1 Pogradec	281 m2	Strehim Social	Bashkia Pogradec	Bashkia Pogradec	Kad i dyle Teknik i ndërteses 4KT	
2	3581/PG-E-4	9/1-1-5 Apartament	Ndërtese ish Ndërmarrja Gjeologjike	Lagja nr 1 Pogradec	281 m2	Strehim Social	Bashkia Pogradec	Bashkia Pogradec	Kad i trete teknik i ndërteses 4KT	

PLANIMETRIA E KATIT TIP (kati i trete)

SIPERFAQE TOTALE 281 M2



SIPERFAQE SHFRYTEZIMI 190 M2

SIPERFAQE SHKALLE 19 M2 M2

SIPERFAQE MURATURE 50.5 M2 M2

SIPERFAQE BALLKONESH 21.5 M2

SH 1:100



MIRATOHET

KRYETARI


ILIR XHAKOLLI



Shkalla Pograde Drejtimi e Planimit Pozicioni i Katit SH 1:100	Emri i objektit ISH NDERMARRJA GJEOLOGJIKE POGRADEC
Emri i projektit PLANIMETRIA TIP: KATI I TRETE	
Drejtori An. Pashaj	Pasqja SH 1:100

SIPERFAQE	TOTALE	281 M2	SIPERFAQE	MURATURE	50.5 M2
SIPERFAQE	SHFRYTEZIMI	190 M2	SIPERFAQE	BALLKONESH	21.5 M2
SIPERFAQE	SHKALLE	19 M2			

A number line from 0 to 1700. Major tick marks are labeled every 100 units: 100, 200, 300, 400, 500, 600, 700, 800, 900, 1000, 1100, 1200, 1300, 1400, 1500, 1600, 1700. Minor tick marks are present every 20 units. The number 1700 is labeled at the far right. The number 973 is marked with a bracket and labeled below the line. The number 726 is marked with a bracket and labeled below the line. The numbers 38, 450, 410, 38, 330, 38, 320, and 38 are marked with brackets and labeled below the line.



KRYETARI

ILIR XHAKOLLU


[illegible]

NR.PROT. 2087/5
DATE 10. 6 .2026

KRYEMINISTRISË
BASHKISË POGRADEÇ
AGJENCISË SHETËRËRE TË KADASTRËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsonida RAMA





www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2026 – Numri: 121

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 11 qershor 2026

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 420, datë 10.6.2026

Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Arsimit, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.....

10979

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 421, datë 10.6.2026

Për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec të pasurive 9/1+1-4 dhe 9/1+1-5, zona kadastrale 8581, me vendndodhje në Njësinë Administrative Pogradec, dhe për një shtesë në vendimin nr. 1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës”, të ndryshuar.....

10996

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 423, datë 10.6.2026

Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....

10999

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 424, datë 10.6.2026

Për krijimin e rezervës së armatimeve dhe të pajisjeve teknologjike për Forcat e Armatosura nga subjektet e licencuara

10999

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 426, datë 10.6.2026

Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim depoje në zonën e Qytetit të Nxënësve”

11002

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 428, datë 10.6.2026

Për përcaktimin e rregullave, dokumentacionit, afateve dhe procedurave të detajuara për plotësimin, dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesës për organizimin e vullnetarizmit nga personi juridik fitimprurës.....

11003

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 430, datë 10.6.2026

Për përcaktimin e zonave të prodhimit të rrushit për verë.....

11004

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 433, datë 10.6.2026

Për dhënie ndihme financiare familjes së inspektor Enea Seladin
Mekollit, ish-punonjës policie, i cili ka humbur jetën në krye të
detyrës.....

11030

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 434, datë 10.6.2026

Për dhënie ndihme financiare inspektor Edison Mitat Adri, punonjës
policie, i plagosur në krye të detyrës.....

11030



VENDIM
Nr. 421, datë 10.6.2026

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË POGRADEÇ TË PASURIVE
9/1+1-4 DHE 9/1+1-5, ZONA
KADASTRALE 8581, ME
VENDNDODHJE NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE POGRADEÇ, DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
1240, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË
POGRADEÇ, TË QARKUT TË KORÇËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec të pasurive 9/1+1-4 dhe 9/1+1-5, zona

kadastrale 8581, me vendndodhje në Njësinë Administrative Pogradec, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planimetrive, gjithsej, 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t’u përdorur në fushën e strehimit social.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1240, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Pogradec i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.


4. Ngarkohen Bashkia Pogradec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

L.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia Pogradec		Inventarizimi		Adresat		Komponentet përveç të tjerave		Adresat dhe adresat e komponenteve përveç të tjerave		Komponentet përveç të tjerave		Adresat dhe adresat e komponenteve përveç të tjerave		Komponentet përveç të tjerave		Adresat dhe adresat e komponenteve përveç të tjerave		Komponentet përveç të tjerave	
No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës	No. i listës
1	8581/9/1+1-4	9/1+1-4	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat
2	8581/9/1+1-5	9/1+1-5	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat	Adresat





PLANIMETRIA E KATIT TIP (kati i dyte)


SIPERFAQE TOTALE 281 M² SIPERFAQE MURATURE 50.5 M² M²SIPERFAQE SHFRYTEZIMI 190 M² SIPERFAQE BALLKONESH 21.5 M²SIPERFAQE SHKALLE 19 M² M²

MIRATOHET

KRYETARI

ILIR XHAKOLLU

SH 1:100



Emri i Projektit	ISH MURGJATIA GJEOLOGJIKE PORRADEC
Emri i Autorit	PLANIMETRIA TIP KATI I DYTE
Emri i Klientit	SH 1:100
Emri i Projektit	ISH MURGJATIA GJEOLOGJIKE PORRADEC
Emri i Autorit	PLANIMETRIA TIP KATI I DYTE
Emri i Klientit	SH 1:100



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Nr. 3787/5 Prot.

Pogradec, më 28.09.2023

VENDIM

NR. 104, DATË 27.09.2023

"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK

1. Pranë Bashkisë së Pogradecit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1) Nënkyetar i Bashkisë Pogradec	(Paskalino Ziko)	Kryetar
2) Drejtor i Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokave Bujqësore në Njësitë Administrative	(Besmira Niko)	Anëtar
3) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	(Ivana Llakmani)	Anëtar
4) Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve	(Dritan Balliu)	Anëtar
5) Përfaqësues i Komuniteteve të Interesuara (Rome/Egjyptiane)	(Shpëtim Dute)	Anëtar
6) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Arbër Male)	Anëtar
7) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Vjollca Pllaha)	Anëtar

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore").

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KESHILLI

Nr 2276/Prot.
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

NR. 65, DATË 29.05.2024

PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL "PERMIRESIMI I KUSHTEVE TE BANIMIT PER FAMILJET E PAFAVORIZUARA".

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 22/2018 "PËR STREHIMIN SOCIAL" përkatësisht: Nenit 2, pika: 13,14,15,20,25,27,44,49, 51; Neni 3, pika 3 ; Neni 40,41,42,43 "PËR PERMIRESIMIN E KUSHTEVE TE BANIMIT", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin "Përmirësimi i kushteve të banimit për familjet e pafavorizuara".

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "PERMIRESIMI I KUSHTEVE TE BANIMIT PER FAMILJET E PAFAVORIZUARA"		
NR.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	6
ii	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	5
iii	Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	5
iv	Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
v	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.	5
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna.	5
ii	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.	0
iii	Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.	5
iv	Familjet e reja, ku moshë e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	8



i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie.	4
ii	Individë me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.	2
iii	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.	0
iv	Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese.	2
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
vi,	Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	3
vii,	Punonjësit e repartit RENE A	
viii	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	
ix	Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit	3
x	Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian	4
xi	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
xii	Vajzat Nëna.	3
xiii	Individët që i përkasin komuniteti LGBTI, të cilët janë viktimë për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor	2
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	7
ii	Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
iii	Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
	TOTALI PIKË	100

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 20.05.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 840/14 Prot.

Pogradec, më 26.02.2026

VENDIM

NR. 23, DATË 25.02.2026

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE
TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.05.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 38 të Ligjit 22/2018 “Për Strehimin social” i ndryshuar, në pika 4 e VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qerasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM Nr.459 datë 03.07.2019 Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qerasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimit ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKB mbi miratimin “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026”, Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, Ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ; paraqesim për miratim vlerën maksimale të subvencionimit të qerasë dhe vlerën mesatare të qerasë në tregun e lirë për programin “Subvencionimi i Qerasë” që zbatohet nga Bashkia Pogradec dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

- 1.Të miratojë nivelin e qerasë mesatare në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec, sipas tabelës bashkangjitur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ; Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhmit Financiar, Drejtoria Emergjencave, Strehimit, Pronësisë dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të tokës dhe supervizimit të shërbimeve Bashkia Pogradec .



Tabela.1

Niveli mesatar i çerasë në tregun e lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2025.

Nr	Emërtimi, tip i apartamentit	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar
1	Ap.Garsoniere	muaj	1	7,000 lek
2	Ap. 1+1	muaj	1	12,000 lek
3	Ap. 2+1	muaj	1	15,000 lek
4	Ap. 3+1	muaj	1	20,000 lek

3.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLA



1.Miratuar me 22 vota

2.Vota Pro 22

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 25.02.2026